



*Empowered lives.
Resilient nations.*



UDHËZIM

PËR TRAJTIMIN E
RIEKSPORTEVE OSE
RITRANSFERIMEVE TË
PAAUTORIZUARA
TË ARMËVE DHE
MUNICIONEVE

Qendra e Evropës Lindore dhe Juglindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (SEESAC) ka një mandat nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara dhe Këshilli për Bashkëpunim Rajonal për të mbështetur të gjithë partnerët kombëtare dhe ndërkombëtarë duke fuqizuar kapacitetet kombëtare dhe rajonale për të kontrolluar dhe reduktuar përhapjen dhe përdorimin e paligjshëm të armëve të vogla dhe të lehta, dhe si rrjedhojë të kontribuojë në përmirësimin e stabilitetit, sigurisë dhe zhvillimit në Evropën Juglindore dhe Lindore.

Për më shumë informacion kontakto:

Koordinator i SEESAC

Hadži Melentijeva 30

11000 Beograd

Serbi

Tel: (+381) (11) 344 6353; 383 6972; 383 6974

Fax: (+381) (11) 344 6356

www.seesac.org

UDHËZIM PËR TRAJTIMIN E RIEKSPORTEVE OSE RITRANSFERIMEVE TË PAAUTORIZUARA TË ARMËVE DHE MUNICIONEVE

FALENDERIME

Ky udhëzim u përgatit nga Mark Bromley dhe Lawrence Dermody dhe u redaktua nga anëtarë të skuadrës së SEESAC: Dr. Ivan Zveržhanovski, Slobodan Bošković dhe Iva Savić.



NORWEGIAN MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS

Publikimi i këtij udhëzimi u mbështet bujarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Norvegjisë nëpërmjet projektit për Mbështetjen e SEESAC për një Program të Kontrollit të Armëve në Ballkanin Perëndimor – Faza 2.

Shtypur nga: DMD

Tirazhi: 50

© SEESAC 2014 – Të gjitha të drejtat e rezervuara

ISBN: 978-86-7728-216-5

Pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal ose të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara.

PËRMBAJTJA

1. VENDOSJA E KONTROLLEVE PËR RIEKSORTIN DHE RITRANSFERIMIN	7
1.1. Kategorizimi i llojeve të ndryshme të detyrimeve që mund të zbatohen	8
1.2. Përfshirja e vërtetimeve të përdorimit fundor në certifikatat e përdoruesit fundor, deklaratat e përdoruesit fundor dhe kontratat tregtare	10
1.3. Vlerësimi i mjeteve për individët dhe shoqëritë private dhe i mjeteve për përfshirjen në një sistem armësh dhe rieksportin	14
2. ZBATIMI DHE MONITORIMI I KONTROLLEVE TË RIEKSORTIT DHE RITRANSFERIMIT	15
2.1. Mekanizma efikase të vlerësimit të rrezikut të licencimit të eksportit	16
2.2. Mekanizmat për të garantuar që artikujt arrijnë te përdoruesi fundor i synuar	18
2.3. Masat për të konfirmuar kryerjen e kontrolleve të rieksportit dhe ritransferimit	20
3. MASAT E MARRA NË RASTET E SHKELJEVE TË KUFIZIMEVE PËR RIEKSORTIN OSE RITRANSFERIMIN	23
3.1. Hapat që duhen ndërmarrë kur zbulohen shkelje të kontrolleve të rieksportit dhe ritransferimit	24
3.2. Hartimi i udhëzimeve që parashtrajnë marrjen e masave për raste të tilla	28

UDHEZIM PËR KONTROLLET GJATË RIEKSPORTIT DHE RITRANSFERIMIT

Ky udhezim bazohet në udhëzimet egzistuese dhe dokumentat e praktikave më të mira dhe në praktikat kombëtare për të ofruar sugjerime praktike për autoritetet licencuese të eksporteve të Evropës Juglindore mbi pikat në vijim:

- ▶ Si të vendosim kontrole për riekспортin dhe ritransferimin
- ▶ Si t'i zbatojmë dhe monitorojmë kontrollet për riekспортin dhe ritransferimin
- ▶ Si të zbulojmë rastet e rieksporteve dhe ritransferimeve të paautorizuara
- ▶ Si t'i hetojmë ato më tej
- ▶ Si të mbrohemi nga përsëritja e tyre në të ardhmen

Udhezimi paraqet shembuj të praktikës së mirë, përfshirë gjuhën e duhur nga udhëzimet përkatëse dhe dokumentat e praktikave më të mira, shembuj të vlefshëm nga praktikat dhe politikat kombëtare të shteteve të ndryshme dhe mësimet praktike të nxjerra nga rastet e shkeljeve të kontroleve gjatë riekспортit dhe ritransferimit. Ky udhezim ka për qëllim që të paraqesë shembuj praktikë të përshtatshëm për nevojat dhe burimet e shteteve në Evropën Juglindore dhe nuk synon të prezantojë diçka të pamundur për tu zbatuar.



VENDOSJA E KONTROLLEVE PËR RIEKSPORTIN DHE RITRANSFERIMIN

1.1. KATEGORIZIMI I LLOJEVE TË NDRYSHME TË DETYRIMEVE QË MUND TË ZBATOHEN

Kontrollet për riekSPORTIN dhe ritransferimin e armëve dhe municioneve të eksportuara mund të jenë të formave të ndryshme. Detyrimet e rekomanduara nga udhëzimet ekzistuese dhe dokumentet e praktikave më të mira, të cilat përdoren aktualisht nga shtetet eksportuese, ndahen në gjashtë kategori të ndryshme. Në secilin rast, mund të vendosen kufizime si për riekSPORTIN ashtu edhe për ritransferimin, ose vetëm për riekSPORTIN.

▶ **ALTERNATIVA 1.
NDALIMI I RIEKSORTIT NË NJË DESTINACION TJETËR**

Në këtë rast, shteti importues ose përdoruesi fundor është i detyruar që të mos i riekSPORTOJË në një destinacion tjetër armët dhe municionet e importuara.

▶ **ALTERNATIVA 2.
NDALIMI I RIEKSORTIT, ME PËRJASHTIM TË DESTINACIONEVE TË CAKTUARA**

Në këtë rast, shteti importues ose përdoruesi fundor është i detyruar që të mos i riekSPORTOJË armët dhe municionet e importuara, me përjashtim të disa destinacioneve të caktuara. Në raste të tilla, destinacionet e miratuara për riekSPORTIN duhet të kufizohen në ato destinacione që paraqesin rrezik të ulët për eksporte të paligjshme ose të papërgjegjshme, ose për përdorim fundor të papërshtatshëm.

▶ **ALTERNATIVA 3.
NDALIMI I RITRANSFERIMIT TE NJË PËRDORUES FUNDOR OSE VENDNDODHJE TJETËR, APO PËR NJË PËRDORIM FUNDOR TJETËR**

Në këtë rast, shteti importues ose përdoruesi fundor është i detyruar që të mos i ritransferojë armët dhe municionet e importuara te një përdorues fundor ose në një vendndodhje tjetër apo për një përdorim fundor tjetër. Në raste të tilla, kufizimet specifike në lidhje me përdoruesin fundor, vendndodhjen apo përdorimin fundor të miratuar përfshihen në EUC ose dokumente të tjera përkatëse. Këto ndalime përfaqësojnë kufizimet në lidhje me përdorimin e armëve nga shteti importues pas dërgimit të tyre, madje edhe nëse ato mbeten nën kontrollin e shtetit importues apo brenda territorit të tij.

▶ ALTERNATIVA 4.

AUTORIZIMI PARAPRAK PËRPARA ÇDO RIEKSPORTI OSE RITRANSFERIMI

Në këtë rast, shteti importues ose përdoruesi fundor është i detyruar që armët dhe municionet e importuara t'i rieksportojë ose ritransferojë vetëm pas autorizimit paraparak nga shteti eksportues fillestar. Këto kufizime mund të vendosen për riekSPORTIN, ritransferimin ose për të dyja së bashku. Detyrimi për të marrë autorizim përpara çfarëdo riekSPORTI apo ritransferimi i jep shtetit eksportues fillestar mundësinë që të vendosë veton për riekSPORTE apo ritransferime të veçanta.

▶ ALTERNATIVA 5.

NJOFTIMI I ÇDO RIEKSPORTI OSE RITRANSFERIMI

Në këtë rast, shteti importues ose përdoruesi fundor ka detyrimin që të njoftojë shtetin eksportues fillestar për çdo riekSPORT apo ritransferim të armëve dhe municioneve të importuara. Këto kufizime mund të vendosen për riekSPORTIN, ritransferimin ose për të dyja së bashku. Një detyrim i tillë i siguron shtetit eksportues fillestar një mënyrë për monitorimin e përdorimit fundor dhe informacione që mund të jenë të vlefshme gjatë hetimit të çfarëdo raporti në lidhje me dërgimin e armëve dhe municioneve në vendet ku zbatohen embargot e Kombeve të Bashkuara për armët ose palët në konflikt.

▶ ALTERNATIVA 6.

DHËNIA E PËRGJEGJËSISË PËR RIEKSPORTIN OSE RITRANSFERIMIN SHITETIT IMPORTUES

Në këtë rast, shtetit importues i jepet përgjegjësia e kontrollit të çdo riekSPORTI ose ritransferimi të armëve dhe municioneve të importuara. Dhënia ose mosdhënia e kësaj përgjegjësie do të varet nga (a) mallrat që eksportohen, (b) përdoruesi fundor dhe (c) destinacioni. Konkretisht, shtetet mund të vendosin kontrolle të rrepta për eksportet e sistemeve të plota të armëve të një qeveri ku vendi i destinacionit ka të dhëna të dobëta në lidhje me kontrollet e eksportit. Nga ana tjetër, shtetet mund të vendosin kontrolle më pak të rrepta për eksportet e komponentëve të një përdoruesi fundor privat, ku vendi i destinacionit ka të dhëna të mira për kontrollet e eksportit.

- ▶ Shtetet duhet të përipiqen gjithmonë që të mbajnë kontrolle më të rrepta për përdoruesit fundorë, destinacionet dhe mallrat me rrezik më të lartë. Këtu përfshihet sidomos zbatimi i Marrëveshjes së Wassenaar-it dhe i udhëzimeve përkatëse të OSBE-së për eksportet e Sistemeve të Mbrojtjes Ajrore të Manovrueshme (MANPADS).
 - ▶ Shtetet mund t'i bëjnë publike udhëzimet e tyre kombëtare për llojet dhe rrethanat e kryerjes së kontrolleve të riekSPORTIT ose ritransferimit.
 - ▶ Pavarësisht faktit nëse udhëzimet kombëtare bëhen publike apo mbahen konfidenciale, ato duhet të zbatohen në mënyrë të qartë dhe të vazhdueshme. Ato gjithashtu duhet të përputhen me udhëzimet përkatëse dhe dokumentet e praktikave më të mira dhe duhet t'i rezistojnë vëmendjes publike nëse do të duhet të diskutohen dhe të analizohen në kontekstin e raportimit të një riekSPORTI ose ritransferimi të paautorizuar.
-

1.2. PËRFSHIRJA E VËRTETIMEVE TË PËRDORIMIT FUNDOR NË CERTIFIKATAT E PËRDORUESIT FUNDOR, DEKLARATAT E PËRDORUESIT FUNDOR DHE KONTRATAT TREGTARE

Kontrollet e riekспортit dhe ritransferimit duhet të vendosen përmes përfshirjes së vërtetimeve të posaçme të përdorimit fundor në EUC (për përdoruesit fundorë shtetërorë) ose deklaratat e përdoruesve fundorë (për përdoruesit fundorë privatë) që shoqërojnë eksportin. Kontrollet e riekспортit dhe ritransferimit mund të vendosen edhe duke përfshirë vërtetimet e posaçme të përdorimit fundor në kontratën që tregtare që shoqëron eksportin.

Në rastet kur shteti importues bëhet përgjegjës për kontrollin e çfarëdo riekporti ose ritransferimi të armëve dhe municioneve të importuara, certifikatat ndërkombëtare të importit mund të përdoren edhe për kryerjen e kontrolleve të riekспортit dhe ritransferimit.

Në të gjitha rastet, gjuha e përdorur duhet të jetë sa më e qartë që të jetë e mundur. Në vecanti, gjuha e përdorur duhet të tregojë qartë që kontrollet e vendosura zbatohen njësoj për të gjitha llojet e transferimit, përfshirë shitjet, kreditë, qiratë dhe dhuratat. Mospërfshirja në mënyrë të qartë e të gjitha llojeve të transferimit mund të lërë vend për keqkuptime ose keqinterpretime të qëllimshme ose të paqëllimshme nga përdoruesi fundor ose shteti importues.

Gjuha e dhënë në vijim për t'u përfshirë në certifikatat ose deklaratat e përdoruesit fundor është e zbatueshme për alternativat e identifikuara më lart.¹

▶ ALTERNATIVA 1.

NDALIMI I RIEKSPORTIT OSE RITRANSFERIMIT

GJUHA QË MUND TË PËRDORET:

Unë/Ne/përdoruesi fundor [EMRI I PËRDORUESIT FUNDOR] vërtetoj/me se artikujt [PËRSHKRIMI I ARTIKUJVE] nuk do të eksportohen, shiten, jepen me qira ose transferohen, përkohësisht apo përgjithmonë, me ose pa kompensim, në asnjë shtet të tretë apo subjekt ose person juridik në [EMRI I SHTETIT TË PËRDORUESIT FUNDOR], të ndryshëm nga përdoruesi fundor i cituar.

¹ Përshtatur sipas OSBE-së, (shënimi 13).

▶ ALTERNATIVA 2.

NDALIMI I RIEKSPORTIT OSE RITRANSFERIMIT, ME PËRJASHTIM TË DISA DESTINACIONEVE DHE PËRDORUESVE FUNDORË TË CAKTUAR

GJUHA QË MUND TË PËRDORET:

Unë/Ne/përdoruesi fundor [EMRI I PËRDORUESIT FUNDOR] vërtetoj/me se artikujt [PËRSHKRIMI I ARTIKUJVE] nuk do të eksportohen, shiten, jepen me qira ose transferohen, përkohësisht apo përgjithmonë, me ose pa kompensim, në asnjë shtet të tretë apo subjekt ose person juridik në [EMRI I SHTETIT TË PËRDORUESIT FUNDOR] të ndryshëm nga përdoruesi fundor i cituar, me përjashtim të destinacioneve të mëposhtme [EMRI/AT E SHTETEVE IMPORTUESE QË I NËN-SHTROHEN PËRJASHTIMEVE].

▶ ALTERNATIVA 3.

NDALIMI I RITRANSFERIMIT TE NJË PËRDORUES FUNDOR OSE VENDNDODHJE TJETËR, APO PËR NJË PËRDORIM FUNDOR TJETËR

GJUHA QË MUND TË PËRDORET:

Gjuha që mund të përdoret për ndalimin e ritransferimit të një përdoruesi fundor tjetër në shtetin importues:

Unë/Ne/përdoruesi fundor [EMRI I PËRDORUESIT FUNDOR] vërtetoj/me se artikujt [PËRSHKRIMI I ARTIKUJVE] do të përdoren vetëm nga përdoruesi fundor [EMRI I PËRDORUESIT FUNDOR]

Gjuha që mund të përdoret për ndalimin e ritransferimit të një vendndodhje tjetër në shtetin importues:

Unë/Ne/përdoruesi fundor [EMRI I PËRDORUESIT FUNDOR] vërtetoj/me se artikujt [PËRSHKRIMI I ARTIKUJVE] do të përdoren vetëm në vendin [VENDODHJA E ARTIKUJVE].

Gjuha që mund të përdoret për ndalimin e ritransferimit për përdorim fundor tjetër:

Unë/ne/përdoruesi fundor [EMRI I PËRDORUESIT FUNDOR] vërtetoj/me se artikujt [PËRSHKRIMI I ARTIKUJVE] do të përdoren vetëm për përdorimin fundor të cituar.

▶ ALTERNATIVA 4.
AUTORIZIMI PARAPRAK PËRPARA ÇDO RIEKSPORTI OSE RITRANSFERIMI

GJUHA QË MUND TË PËRDORET:

Unë/ne/përdoruesi fundor [EMRI I PËRDORUESIT FUNDOR] vërtetoj/me se artikujt [PËRSHKRIMI I ARTIKUJVE] nuk do të eksportohen, shiten, jepen me qira ose transferohen, përkohësisht apo përgjithmonë, me ose pa kompensim, në asnjë shtet të tretë apo subjekt ose person juridik tjetër në [EMRI I SHTETIT TË PËRDORUESIT FUNDOR] të ndryshëm nga përdoruesi fundor i cituar pa miratimin me shkrim të agjencisë shtetërore të autorizuar të [EMRI I SHTETIT EKSPORTUES].

▶ ALTERNATIVA 5.
NJOFTIMI I ÇDO RIEKSPORTI OSE RITRANSFERIMI

GJUHA QË MUND TË PËRDORET:

Unë/ne/përdoruesi fundor [EMRI I PËRDORUESIT FUNDOR] vërtetoj/me se artikujt [PËRSHKRIMI I ARTIKUJVE] nuk do të eksportohen, shiten, jepen me qira ose transferohen, përkohësisht apo përgjithmonë, me ose pa kompensim, në asnjë shtet të tretë apo subjekt ose person juridik tjetër në [EMRI I SHTETIT TË PËRDORUESIT FUNDOR] të ndryshëm nga përdoruesi fundor i cituar pa njoftuar agjencinë shtetërore të autorizuar të [EMRI I SHTETIT EKSPORTUES].

▶ ALTERNATIVA 6.
DHËNIA E PËRGJEGJËSISË PËR RIEKSPORTIN OSE RITRANSFERIMIN SHTETIT IMPORTUES

GJUHA QË MUND TË PËRDORET:

Unë/ne/përdoruesi fundor [EMRI I PËRDORUESIT FUNDOR] vërtetoj se artikujt [PËRSHKRIMI I ARTIKUJVE] nuk do të eksportohen, shiten, jepen me qira ose transferohen, përkohësisht apo përgjithmonë, me ose pa kompensim, në asnjë shtet të tretë apo subjekt ose person juridik tjetër në [EMRI I SHTETIT TË PËRDORUESIT FUNDOR] të ndryshëm nga përdoruesi fundor i cituar, pa miratimin me shkrim të agjencisë shtetërore të autorizuar të [EMRI I SHTETIT TË PËRDPORIMIT FUNDOR].

Shumica e autoriteteve të licencimit të eksportit mbështeten në dokumentacionin e lëshuar nga shteti importues kur vlerësojnë aplikimet për licencë eksporti. Kjo mund të krijojë probleme kur shtetet eksportuese kërkojnë të kontrollojnë formulimin e saktë të vërtetimeve të përdoruesit fundor ose të sigurohen që dokumentacioni përmban të gjitha elementet e sigurisë dhe gjuhën e rekomanduar. Një qasje tjetër do të ishte që shtetet eksportuese të lëshojnë EUC-të e tyre në vend që të mbështeten në dokumentacionin e lëshuar nga përdoruesi fundor (shih kutinë 1).

KUTIA 1:

NJË ALTERNATIVË PËR CERTIFIKATAT E PËRDORUESIT FUNDOR: RASTI I SUEDISË

Suedia nxjerr certifikatat e saj të përdorimit fundor (EUC) dhe nuk përdor dokumentacionin e lëshuar nga përdoruesi fundor. EUC-të printohen në letër kartëmonedhash. Eksportuesi suedez duhet të verifikojë që ato janë plotësuar nga klientët e propozuar të tyre, përpara lëshimit të licencës së eksportit. Më pas, një kopje e nënshkruar e EUC-së i dërgohet autoritetit licencues suedez nëpërmjet ambasadës suedeze në shtetin eksportues.^a Për eksportet e armëve të vogla dhe të lehta, autoritetet suedeze kërkojnë edhe certifikatën për armët e vogla dhe të lehta që përdoruesi fundor i jep eksportuesit suedez në letrën e tij zyrtare me kokë. Kjo certifikatë duhet t'i dorëzohet edhe autoritetit licencues suedez si pjesë e aplikimit për licencë.^b

a Agjencia Suedeze për Moshpërndarjen dhe Kontrollin e Eksportit, "certifikata e përdoruesit fundor", 16 korrik 2009, <<http://www.isp.se/sa/node.asp?node=543>>.

b Agjencia Suedeze për Moshpërndarjen dhe Kontrollin e Eksportit, "certifikata dhe formularë të tjerë", 16 korrik 2009, <<http://www.isp.se/sa/node.asp?node=551>>.

Burimi: Mark Bromley dhe Hugh Griffiths, "Certifikatat e përdoruesit fundor: përmirësimi i standardeve për parandalimin e devijimeve", informacione nga SIPRI mbi paqen dhe sigurinë nr. 2010/3, mars 2010, <http://books.sipri.org/product_info?c_product_id=398>.

1.3. VLERËSIMI I MJETEVE PËR INDIVIDËT DHE SHOQËRITË PRIVATE DHE I MJETEVE PËR PËRFSHIRJEN NË NJË SISTEM ARMËSH DHE RIEKSPORTIN

Eksporte të caktuara mund të paraqesin sfida të veçanta. Këtu përfshihen rastet kur armët i dërgohen një personi ose shoqërie private ose kur komponentët e tyre i dërgohen një shoqërie private, e cila do t'i përfshijë ato në një sistem armësh që do të rieksporthet në një shtet tjetër. Këto eksporte duhet të miratohen vetëm nëse personi ose shoqëria private ka marrë autorizimet e nevojshme nga autoritetet kompetente të shtetit importues, si p.sh. licencën e importit dhe vërtetimin e deklaratës së përdoruesit fundor.

Në rastet e riekспортit të armëve ose të sistemeve të plota të armëve, shoqërisë eksportuese duhet t'i kërkohet të japë informacione mbi përdoruesin fundor final, si pjesë e aplikimit për licencë eksporti. Gjatë vlerësimit të licencës së eksportit, përfshirë vlerësimin e rrezikut të mundshëm të devijimeve gjatë ose pas transportit (shih më poshtë), duhet të merret në konsideratë si identiteti i importuesit ashtu edhe i përdoruesit fundor final.

Në rastet kur ka gjasa që armët ose sistemet e plota të armëve do të rieksporthen, por nuk dihet përdoruesi fundor final, importuesi duhet të ofrojë garanci që rieksporet e ardhshme do të kontrollohen nga autoriteti licencues i shtetit importues. Përveç kësaj, gjatë vlerësimit të rrezikut të licencës së eksportit vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet kontrolleve për licencimin e eksporteve të shtetit importues. Çështjet që duhet të shqyrtohen përfshijnë:

- ▶ Nëse shteti importues ka një sistem efikas kontrollesh për eksportin e armëve;
- ▶ Nëse shteti importues është anëtar i regjimeve dhe marrëveshjeve përkatëse për kontrollin e eksportit, si Qëndrimi i Përbashkët i BE-së dhe Marrëveshja e Wassenaar-it; dhe
- ▶ Nëse shteti importues ka një histori eksportesh të papërgjegjshme armësh.



ZBATIMI DHE MONITORIMI I KONTROLLEVE TË RIEKSPORTIT DHE RITRANSFERIMIT

2.1. MEKANIZMA EFIKASE TË VLERËSIMIT TË RREZIKUT TË LICENCIMIT TË EKSPORTIT

Çdo EUC e lëshuar nga shteti për një transferim të caktuar duhet të përmbajë listën e përbashkët të “elementeve thelbësore” dhe “elementeve opsionale shtesë” që janë theksuar në udhëzimet përkatëse të BE-së, OSBE-së dhe Marrëveshjes së Wassenaar-it dhe dokumentet e praktikave më të mira (shih kutinë 2).

KUTIA 2:

ELEMENTET QË DUHET TË KËRKOJNË AUTORITETET E LICENSIMIT TË EKSPORTIT NË CERTIFIKATAT E PËRDORUESIT FUNDOR TË LËSHUARA NGA QEVERIA

Elementet thelbësore

- Të dhënat e eksportuesit dhe përdoruesit fundor (të paktën emrin, adresën dhe emrin tregtar)
- Numri i kontratës ose referenca dhe data e porosisë
- Shteti i destinacionit përfundimtar
- Përshkrimi i mallrave që do të eksportohen (lloji, karakteristikat) ose referenca e kontratës së lidhur me autoritetet e shtetit të destinacionit përfundimtar
- Sasia dhe/ose vlera e mallrave të eksportuara
- Nënshkrimi, emri dhe pozicioni i përfaqësuesit të përdoruesit fundor
- Data e lëshimit të certifikatës së përdoruesit fundor
- Përdorimi fundor i mallrave
- Një garanci, sipas rastit, që mallrat që do të eksportohen nuk do të përdoren për qëllime të ndryshme nga përdorimi i deklaruar

Elemente opsionale shtesë

- Të dhënat e plota, sipas rastit, të çdo ndërmjetësuesi të përfshirë në transferim
- Gatishmëria e importuesit për t'i dhënë shtetit eksportues një dokument që të konfirmojë dorëzimin, sipas kërkesës
- Vërtetimi që mallrat do të instalohen në ambientet e përdoruesit fundor ose do të përdoren vetëm nga ai
- Marrëveshja nga importuesi ose përdoruesi fundor për lejimin e verifikimit në vend
- Një klauzolë që ndalon riekportin e mallrave të përfshira në certifikatë
- Garancia nga importuesi ose përdoruesi fundor që çdo riekport do të kryhet vetëm nën autoritetin e autoriteteve të licencimit të eksportit të importuesit ose të përdoruesit fundor
- Garantimi nga importuesi ose përdoruesi fundor që mallrat e përfshira në certifikatën ose deklaratën e përdorimit fundor nuk do të devijohen ose zhvendosen në një destinacion apo vendndodhje tjetër në shtetin importues

Burimet: OSBE, Udhëzues i praktikave më të mira për kontrollin e eksportit të armëve të vogla dhe të lehta, manual për praktikën më të mira në lidhje me armët e vogla dhe të lehta (OSBE: Vjenë, 2003), fq. 53-54; OSBE, Forumi për Bashkëpunimin në fushën e sigurisë, “Elementet standarde të certifikatave të përdoruesit fundor dhe të procedurave të verifikimit për eksportet e SALW-ve”, vendim nr. 5/04, dokumenti FSC/DEC/5/04, 17 nëntor 2004; Marrëveshja e Wassenaar-it, “Lista treguese e unifikuar e vërtetimeve të përdoruesit fundor të përdorura më shpesh”, miratuar në vitin 1999, rishikuar në vitin 2005 <<http://www.wassenaar.org/publicdocuments/>>; dhe Këshilli i Bashkimit Evropian, “Udhëzues për Qëndrimin e Përbashkët të Këshillit 2008/944/CSDP në të cilin përkufizohen rregullat e përbashkëta për kontrollin e eksporteve të teknologjive dhe pajisjeve ushtarake”, dokumenti 9241/09, 29 prill 2009.

Shtetet duhet të ndajnë midis tyre shembuj të EUC-ve të shteteve importuese, veçanërisht ato që dyshohet se kanë pasur raste devijimesh ose rieksporuesh apo rritransferimesh të paautorizuara. Në këtë mënyrë, shtetet në Evropën Juglindore duhet të përdorin bazën e të dhënave të brokerimit që mban Zyra Qendrore e Evropës Juglindore dhe Lindore për Kontrollin e Armëve të Vogla e të Lehta (SEESAC), e cila mundëson që shtetet të shkëmbejnë me njëri-tjetrin EUC-të që kanë marrë.² Shtetet duhet të përdorin edhe informacionin e mbledhur gjatë shkëmbimit të informacionit për EUC-të, të zhvilluar nga OSBE-ja në vitin 2008.³

EUC-të duhet të nënshkruhen nga një përfaqësues i lartë i qeverisë dhe, në varësi të rëndësisë së eksportit në fjalë, vërtetimet e dhëna duhet të shënohen përsëri në një shënim diplomatik.

Sipas udhëzimeve të Veprimit Koordinues të Kombeve të Bashkuara për Armët e Vogla (CASA) për vitin 2014 në lidhje me transferimin e armëve të vogla dhe të lehta (SALW), dhënia e dokumentacionit, si për shembull certifikatat dhe deklaratat e përdoruesit fundor “nuk do të jetë baza e vetme për të vendosur në lidhje me dhënien e autorizimit për një eksport. Dokumentacioni do të jetë vetëm një pjesë e një vlerësimi gjithëpërfshirës të aplikimit për autorizimin e eksportit.”⁴ Sipas udhëzuesit të BE-së, “përdorimi i certifikatave të përdoruesit fundor nuk mund të zëvendësojë vlerësimin e plotë të rrezikut të situatës në rastin e veçantë.”⁵

Qëndrimi i Përbashkët i Bashkimit Evropian në lidhje me Eksportet e Armëve paraqet një listë të faktorëve që duhet të merren në konsideratë për t'u mbrojtur nga rreziku i devijimeve gjatë ose pas transportimit. Ata janë:

- ▶ interesat legjitime të sigurisë dhe mbrojtjes së brendshme të vendit marrës, përfshirë çdo pjesëmarrje në aktivitetet paqeruajtëse të OKB-së ose të tjera;
- ▶ aftësia teknike e vendit marrës për të përdorur teknologjinë ose pajisjet;
- ▶ aftësia e vendit marrës për të kryer kontrole efektive mbi eksportin;
- ▶ rreziku i rieksporimit të këtyre teknologjive ose pajisjeve në destinacione të padëshirueshme dhe të dhënat e vendit marrës për sa i përket respektimit të çdo dispozite për rieksporin ose miratimin përpara rieksporimit, të cilat shteti eksportues anëtar i konsideron si të domosdoshme;
- ▶ rreziku që këto teknologji ose pajisje të devijojnë destinacionin e t'i dërgohen organizatave terroriste ose terroristëve të veçantë;
- ▶ rreziku i çmontimit ose transferimit të paqëllimshëm të teknologjisë.⁶

Informacioni në lidhje me çdo rast të raportuar të rieksporimit ose rritransferimit të paautorizuar, përfshirë rastet që kanë të bëjnë me eksportet nga shtetet eksportuese dhe eksportet nga shtete të tjera, duhet të përfshihet në vlerësimin e rrezikut që kryhet për çdo aplikim për licencë eksporti.

Për këtë qëllim, autoritetet e kontrollit të eksportit duhet të mbajnë një listë të përdoruesve fundorë që kanë qenë të përfshirë në rastet e rieksporimeve ose rritransferimeve të paautorizuara.

2 SEESAC, “Baza e të dhënave të brokerimit”, <<http://www.seesac.org/project.php?f1=126&f2=154&f3=180>>.

3 Në nëntor të vitit 2008, shtetet pjesëtare në OSBE ranë dakord që t'u “jepnin të gjitha shteteve të tjera pjesëtare një format tip të certifikatës së tyre kombëtare për përdoruesit fundorë dhe/ose të dokumenteve të tjera përkatëse”. OSBE, Forumi për bashkëpunimin në fushën e sigurisë, “Shkëmbim informacioni në lidhje me formatet tip të certifikatave të përdoruesit fundor dhe procedurat përkatëse të verifikimit”, vendimi nr. 12/08, dokumenti FSC.DEC/12/08, 12 nëntor 2008.

4 Kombet e Bashkuara, ISACS/03.20 (shënimi 16), fq. 23.

5 Këshilli i Bashkimit Evropian, “Udhëzuesi për Qëndrimin e Përbashkët të Këshillit 2008/944/CSDP në të cilin përkufizohen rregullat e përbashkëta për kontrollin e eksporteve të teknologjive dhe pajisjeve ushtarake”, dokumenti 9241/09, 29 prill 2009, <<http://register.consilium.europa.eu/doc/srv?l=EN&f=ST 9241 2009 INIT>>, f. 87.

6 Qëndrimi i Përbashkët 2008/944/CFSP, 8 dhjetor 2008 që përcakton rregullat e përbashkëta për kontrollin e eksporteve të teknologjive dhe pajisjeve ushtarake, *Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian*, L335, 8 dhjetor 2008.

2.2. MEKANIZMAT PËR TË GARANTUAR QË ARTIKUJT ARRIJNË TE PËRDORUESI FUNDOR I SYNUAR

Pas eksportit të armëve dhe municioneve, shteti eksportues duhet të ndërmarrë hapet për të verifikuar marrjen e artikujve nga përdoruesi fundor i autorizuar. Për këtë qëllim, shteti ose shoqëria eksportuese duhet të kërkojë një certifikatë që konfirmon dorëzimin e mallrave.⁷ Kjo kërkesë duhet të përfshihet në certifikatën ose deklaratën e përdoruesit fundor.⁸

DVC-të (certifikatat e konfirmimit të dorëzimit) mund të ndihmojnë për të garantuar mbërritjen e mallrave në destinacionin apo te marrësi i synuar. Megjithatë, ato nuk kanë ndonjë vlerë të madhe në parandalimin e rieksperteve dhe ritransferimeve të paautorizuara, pasi këto të fundit mund të kryhen shumë kohë pas dorëzimit fillestar.

Në vijim jepet gjuha që duhet të përdoret në certifikatat dhe/ose deklaratat e përdoruesit fundor:

Unë/Ne/, me kërkesë të autoriteteve kompetente të shtetit eksportues, konfirmoj/më marrjen e artikujve [PËRSHKRIMI I ARTIKUJVE].⁹

DVC-ja duhet të përmbajë një grup elementesh thelbësore të përbashkëta. Këto përfshijnë:

- ▶ një numër unik identifikimi;
- ▶ emrin, adresën dhe të dhënat e kontaktit (numri i telefonit, faksi dhe adresa e emailit) të eksportuesit dhe përdoruesit fundor;
- ▶ të dhëna për armët dhe municionet dhe mënyrën e dërgimit;
- ▶ pullën/vulën e administratës doganore ose të autoriteteve të tjera kompetente të shtetit importues;
- ▶ të dhëna që armët dhe municionet janë marrë nga përdoruesi fundor;
- ▶ nënshkrimin, emrin dhe pozicionin e përfaqësuesit të autorizuar të administratës doganore ose një autoriteti tjetër kompetent kombëtar që bën certifikimin.¹⁰

DVC-ja duhet të dërgohet brenda një periudhe kohore të arsyeshme (p.sh. brenda 30 ditëve) nga momenti i zhdoganimit të dërgesës. Pas marrjes së një DVC-je duhet të kryhen kontrole në lidhje me përputhshmërinë e informacionit të përmbajtur në të dhe informacionit të përmbajtur në certifikatën ose deklaratën e përdoruesit fundor, në mënyrë të veçantë për sa u përket të dhënave të përdoruesit fundor, eksportuesit dhe sasisë dhe llojit të armëve dhe municioneve.¹¹ Konkretisht, shteti eksportues duhet

⁷ Certifikata konfirmuese e dorëzimit lëshohet nga autoritetet e shtetit në të cilin ndodhet përdoruesi fundor. Ajo konfirmon që dërgesa e autorizuar ka arritur tashmë te përdoruesi fundor.

⁸ Kombet e Bashkuara, ISACS/03.21 (shënimi 9), fq. 11-13.

⁹ OSBE (shënimi 13).

¹⁰ Shih Kombet e Bashkuara, ISACS/03.21 (shënimi 9), fq. 11-13 për listën e plotë të elementeve të rekomanduara.

¹¹ Kombet e Bashkuara, ISACS/03.21 (shënimi 9), fq. 11-13.

të verifikojë vërtetësinë e “vulës së administratës doganore ose të një autoriteti tjetër kompetent të shtetit importues që ka certifikuar dokumentin; dhe nënshkrimin, emrin dhe pozicionin e përfaqësuesit të administratës doganore ose të autoritetit tjetër kompetent të shtetit importues që ka certifikuar dokumentin.”¹²

Për të ndihmuar me këto procese kontrolli dhe verifikimi mund të përdoren kanalet diplomatike dhe ambasadat e huaja.

¹² Shih Kombet e Bashkuara, ISACS/03.21 (shënimi 9), fq. 11-13 për listën e plotë të elementeve të rekomanduara.

2.3. MASAT PËR TË KONFIRMUAR KRYERJEN E KONTROLLEVE TË RIEKSPORTIT DHE RITRANSFERIMIT

Pas çdo eksporti armësh dhe municionesh, shteti eksportues duhet të ndërmarrë hapat për të verifikuar që janë zbatuar kontrollet e vendosura për riekSPORTIN dhe ritransferimin. Përgjegjëse për të garantuar kryerjen e kontrolleve të riekSPORTIT dhe ritransferimit duhet të jetë vetëm një agjenci qeveritare apo autoritet qeveritar, mundësisht autoriteti i licensimit të eksportit. Në raste të caktuara, përgjegjësia mund t'u delegohet agjencive ose autoriteteve qeveritare të tjera.

2.3.1. INFORMACIONI I MBLEDHUR NGA AMBASADAT OSE AGJENCITË E TJERA QEVERITARE

Pas eksportit të armëve dhe municioneve, ambasada e shtetit të destinacionit duhet të njoftohet në lidhje me dorëzimin dhe të gjitha kontrollet përkatëse për riekSPORTIN ose ritransferimin. Ambasada duhet të ketë edhe detyrën e monitorimit të burimeve përkatëse të informacionit dhe të përcjelljes tek autoriteti i licensimit të eksportit, të raporteve ose shqetësimeve në lidhje me riekSPORTIN ose ritransferimin e paautorizuar.

Kur në shtetin e destinacionit nuk ka ambasada përfaqësuese të shteteve eksportuese, këta të fundit mund të kërkojnë të krijojnë mekanizma që do t'i ndihmojnë të bashkojnë burimet e tyre dhe të ndihmojnë njeri-tjetrin për monitorimin e burimeve përkatëse të informacionit dhe përcjelljen e raporteve ose shqetësimeve në lidhje me riekSPORTIN ose ritransferimin e paautorizuar. Si hap të parë, shtetet mund të mbledhin informacion rreth shteteve në të cilat kanë ambasada dhe të zhvillojnë mekanizma për shkëmbimin e informacionit përkatës.

Burime të tjera informacioni që mund të përdoren janë autoritetet doganore të vendeve, shteti marrës dhe shërbimet kombëtare të inteligjencës.

2.3.2. KËRKESA QË SHOQËRITË TË RAPORTOJNË SHKELJET E DYSHUARA

Shtetet mund të ndihmojnë për të konfirmuar zbatimin e kufizimeve të vendosura për riekSPORTIN ose ritransferimin duke mbledhur informacion nga shoqëria eksportuese. Ky raportim mund të bëhet me dëshirë ose mund të bazohet në kriterin ligjor që i detyron shoqëritë eksportuese t'i raportojnë autoritetit të licensimit të eksportit për çfarëdo informacioni që marrin në lidhje me riekSPORTIN ose ritransferimet e paautorizuara.

2.3.3.

MONITORIMI I BURIMEVE TË TJERA TË INFORMACIONIT

Pas eksportit të armëve dhe municioneve, autoriteti i licencimit të eksportit duhet të monitorojë burimet e hapura përkatëse të informacionit për t'u siguruar që është në dijeni të të gjitha raporteve të rieksporimit ose ritransferimit të paautorizuar. Shembuj të burimeve përkatëse të informacionit përfshijnë:

- ▶ raportet e grupeve ose paneleve të ekspertëve të caktuar nga OKB-ja për monitorimin e sanksioneve të Këshillit të Sigurimit të OKB-së <<http://www.un.org/sc/committees/>>;
- ▶ raportet përkatëse nga Amnesty International, <<http://www.amnesty.org/en/>>;
- ▶ raportet përkatëse nga Human Rights Watch, <<http://www.hrw.org/home>>;
- ▶ raportet përkatëse nga International Crisis Group, <<http://www.crisisgroup.org>>;
- ▶ raportet përkatëse nga Instituti Ndërkombëtar i Kërkimeve për Paqen në Stokholm (SIPRI) <<http://www.sipri.org>>;
- ▶ raportet përkatëse nga Small Arms Survey, <<http://www.smallarmssurvey.org/>>;
- ▶ raportet përkatëse nga Conflict Armament Research, <<http://www.conflictarm.com>>.

2.3.4.

NDARJA E INFORMACIONIT ME QEVERITË E TJERA

Shtetet duhet të përdorin edhe informacionin e dhënë nga shtetet e tjera përmes shkëmbimeve përkatëse. Këtu mund të përfshihet informacioni i dhënë gjatë takimeve të Procesit të SEESAC për shkëmbimin rajonal të informacionit (RIEP) për eksportin e armëve, informacioni i vënë në dispozicion përmes mekanizmave të shkëmbimit të informacionit me COARM dhe në takimet rajonale të COARM, si dhe informacioni i dhënë nëpërmjet kanaleve të tjera jo zyrtare.¹³

2.3.5.

KONTROLLET NË TERREN NË SHTETIN E DESTINACIONIT

Në raste të caktuara, shtetet eksportuese mund të kërkojnë të drejtën për kryerjen e verifikimeve pas dorëzimit. Verifikimet pas dorëzimit (PSV) mund të kryhen nga punonjësit e ambasadës, punonjësit e licensimit të eksportit, punonjësit e doganës ose palë të treta të besuara. Këto kërkesa mund të jenë veçanërisht të rëndësishme kur bëhet fjalë për një rrezik të lartë ose riekспорт apo ritransferim të paautorizuar. Këto kërkesa mund të shërbejnë edhe si një mënyrë për krijimin e besimit në rastet kur rifillohet kryerja e dërgesave drejt një destinacioni ku ka pasur raporte për rieksporite ose ritransferime të paautorizuara.

Në certifikatën ose deklaratën e përdoruesit fundor mund të përfshihet garancia për lejimin e PSV-së. Në vijim jepet gjuha që duhet të përdoret në certifikatat dhe/ose deklaratat e përdoruesit fundor:

¹³ SEESAC, "Procesi për shkëmbimin rajonal të informacionit (RIEP)", <<http://www.seesac.org/project.php?I1=126&I2=154&I3=176>>.

Unë/ne vërtetoj/më se autoritetet kompetente të [EMRI I SHTETIT EKSPORTUES] kanë të drejtë të verifikojnë përdorimin fundor dhe vendin e përdorimit fundor të çdo artikulli të furnizuar në çdo kohë që ata e konsiderojnë të arsyeshme.¹⁴

PSV-të do të kryhen vetëm me miratim paraprak me shkrim nga shteti importues.

2.3.6.

REGJISTRIMI I TË DHËNAVE DHE RAPORTIMI

Autoritetet e licencimit të eksportit duhet të mbajnë të dhëna të sakta, gjithëpërfshirëse dhe lehtësisht të aksesueshme në lidhje me certifikatat dhe deklaratat e përdoruesit fundor, si dhe DVC-të e marra.

Shoqërive eksportuese do t'u kërkohet t'i shenojnë të gjitha armët dhe municionet përpara eksportit dhe të mbajnë të dhënat përkatëse në përputhje me praktikat më të mira dhe standardet ndërkombëtare të pranuar.¹⁵

Sipas udhëzimeve të CASA për kontrollet kombëtare mbi përdoruesin fundor dhe përdorimin fundor të armëve të vogla dhe të lehta të transferuara në shtete të tjera, "Të dhënat do të mbahen për të paktën 20 vjet dhe duhet të mbahen për një kohë të pakufizuar".¹⁶

Shoqërive eksportuese mund t'u kërkohet edhe që t'i japin informacion autoritetit të licencimit të eksportit në rastet kur informohen për ndonjë riekспорт ose ritransferim të paautorizuar. Këto detyrime për sa i përket raportimit janë me rëndësi të veçantë kur shoqëria eksportuese përfshihet në mirëmbajtjen e armëve dhe municioneve të eksportuara.

¹⁴ OSBE (shënimi 13).

¹⁵ Shih Kombet e Bashkuara, Veprimi koordinues për armët e vogla, "Shenimi dhe regjistrimi i të dhënave", Hartimi i standardeve ndërkombëtare për kontrollin e armëve të vogla, ISACS/05.30, versioni 1.0, gusht 2012, <<http://www.smallarmsstandards.org>>.

¹⁶ Kombet e Bashkuara, ISACS/03.21 (shënimi 9), fq. 15.



MASAT E MARRA NË RASTET E SHKELJEVE TË KUFIZIMEVE PËR RIEKSPORTIN OSE RITRANSFERIMIN

3.1. HAPAT QË DUHEN NDËRMARRË KUR ZBULOHEN SHKELJE TË KONTROLLEVE TË RIEKSORTIT DHE RITRANSFERIMIT

Nëse zbulohen informacione, ose raportohen në media, të cilat tregojnë se ka ndodhur riekспорт ose ritransferim i paautorizuar, si kundërpërgjigje mund të merren hapat e mëposhtëm.

3.1.1. VENDOSJA E LINJAVE TË QARTA TË PËRGJEGJËSISË

Përgjegjësinë për koordinimin dhe menaxhimin e të gjithë masave të qeverisë ndaj riekспортit ose ritransferimit të paautorizuar duhet ta mbajë një agjenci qeveritare ose një autoritet qeveritar i vetëm - mundësisht autoriteti që licencon eksportin. Përgjegjësitë e kësaj agjencie qeveritare ose autoriteti qeveritar duhet të përfshijnë përgjigjen për të gjitha pyetjet e mediave ose pyetjet nga qeveri të tjera si edhe koordinimin e veprimeve me shtetin importues.

3.1.2. KOMUNIKIMI I INFORMACIONIT PËR HAPAT E NDËRMARRË TE PARLAMENTI, MEDIA DHE SHTETET PARTNERE

Kur janë përhapur lajme për riekспорт ose ritransferim të paautorizuar për shkak të një raporti të bërë publik nga media, atëherë duhet të bëhen përpjekje për të bërë publik sa më shpejt informacione rreth hapave që po ndërmerren si kundërpërgjigje. Informacioni duhet të jepet brenda pak ditësh pas publikimit të raportit dhe duhet të jepet në formën e një deklaratë për shtyp dhe të përfshijë:

- ▶ të dhëna nga raporti fillestar për riekспорт ose ritransferim të paautorizuar;
- ▶ arsyet pse incidenti i raportuar ka çuar në nisjen e një hetimi;
- ▶ hollësitë për çdo transferim të mundshëm të materialit në fjalë në vendin ose rajonin ku raportohet se janë identifikuar armët dhe municionet;
- ▶ agjencinë qeveritare ose autoritetin që do të menaxhojë të gjithë aspektet e masave të marra nga qeveria ndaj raportit;
- ▶ natyrën e çdo mase të përkohshme që po merret ndërkohë që po kryhet hetimi; dhe
- ▶ hapat që do të ndërmerren për të hetuar dhe për të reaguar ndaj raportit.

Kur hetimi të ketë përfunduar, duhet të bëhen publike informacione shtesë për rezultatet e tij. Informacioni duhet të jepet në formën e një deklarate për shtyp dhe të përfshijë:

- ▶ arsyen se pse u nis hetimi;
- ▶ kur dhe si u krye hetimi;
- ▶ rezultatet e hetimit, duke përfshirë shkaqet e rieksporit ose ritransferimit të paautorizuar të materialit, nëse raporti fillestar është vërtetuar gjatë hetimit;
- ▶ masat e marra si rezultat i hetimit; dhe
- ▶ mënyrën se si incidenti dhe hetimi do të ofrojnë informacione për përpjekjet e ardhshme për të kufizuar rieksporin/ ritransferimin e paautorizuar të eksporteve.

Kur janë përhapur lajme për riekспорт ose ritransferim të paautorizuar, bazuar në informacione konfidenciale të siguruar nga shërbimet e inteligjencës ose nga një shtet tjetër, atëherë mund të tregohet një kujdes më i madh për sa i përket publikimit të informacionit për publikun e gjerë. Aty ku është e mundur, informacioni duhet të bëhet publik sa më parë.

3.1.3.

KËRKESË INFORMACIONI NGA PËRDORUESI FUNDOR

Bazuar në informacionin që shkaktoi reagimin, duhet t'i kërkohet informacion përdoruesit fundor ose shtetit importues që dihet se ka importuar fillimisht armët ose municionet që janë raportuar se janë rieksporuar ose ritransferuar. Në mungesë të informacionit të qartë për identitetin e përdoruesit fundor ose shtetit importues fillestar, duhet të kërkohet informacion nga të gjithë përdoruesit fundorë dhe shtetet importuese që kanë importuar llojin e armëve ose municioneve në fjalë.

Përdoruesit fundorë duhet të kontaktohen nëpërmjet pikave të kontaktit dhe kanaleve të komunikimit të përshtatshme, të cilat mund të përfshijnë:

- ▶ ministritë e jashtme nëpërmjet ambasadorëve në vendin e përdoruesit fundor;
- ▶ ministritë e jashtme nëpërmjet ambasadorëve vendas të përdoruesit fundor; dhe
- ▶ ministritë e mbrojtjes nëpërmjet atasheve ushtarakë vendas.

Informacioni i kërkuar nga përdoruesi fundor duhet të përfshijë:

- ▶ nëse ka pasur ose jo riekспорт ose ritransferim të ndonjë materiali, dhe nëse po,
 - numrin e serisë së materialit në fjalë;
- ▶ kur dhe ku është dislokuar ose magazinuar për herë të fundit materiali; dhe
- ▶ nëse ndonjë nga materialet është raportuar se ka humbur ose është vendosur në vendin e gabuar gjatë auditeve të fundit, dhe nëse po
 - numrin e serisë së materialit në fjalë;
 - datën dhe vendndodhjen e fundit që dihet për materialin;
 - rrethanat në të cilat është humbur ose vendosur në një vend të gabuar; dhe
 - masat e marra për të rritur sigurinë e stokut si rezultat i këtij incidenti.

3.1.4.

PEZULLIMI OSE ANULIMI I LICENCEVE PËR EKSPORT

Gjatë hetimeve për shkelje të mundshme të kontrolleve të rieksporimit ose ritransferimit nuk duhet të lëshohet asnjë licencë e re eksporti për përdoruesin fundor ose shtetin importues që po hetohet. Licencat e eksportit të lëshuara që janë të vlefshme në kohën e incidentit duhet të pezullohen ose të anulohen.

Për të qenë në gjendje për të zbatuar këtë bllokim të licencës, autoriteti i licencimit të eksportit duhet të ketë:

- ▶ burimet dhe aftësitë për të kontaktuar menjëherë eksportuesit që zotërojnë licencën;
- ▶ mundësinë ligjore për të pezulluar ose anuluar licencat dhe aplikimet për licencë;
- ▶ njohuri shumë të mira të të drejtave të eksportuesve, prodhuesve dhe sipërmarrjeve private përkatëse nëse anulimi shkakton humbje financiare; dhe
- ▶ pika kontakti brenda qeverisë në rast se anulimi i licencave cenon marrëdhëniet politike ndërmjet shtetit eksportues dhe shtetit të përdoruesit fundor.

3.1.5.

KUFIZIMET E VENDOSURA PËR EKSPORTET E ARDHSHME DREJT PËRDORUESIT FUNDOR OSE DESTINACIONIT

Verifikimi i shkeljes së qëllimshme të marrëveshjeve me përdoruesit fundorë ose paaftësia për të garantuar që këto marrëveshje do të respektohen nga shtetet importuese duhet të shërbejë si informacion për vendimet e ardhshme për dhënien e licencave të eksportit. Llojet e kufizimeve që duhen marrë në konsideratë kur ka ndodhur riekспорт ose ritransferim i paautorizuar përfshijnë:

- ▶ një bllokim për një afat të papërcaktuar të eksporteve drejt vendit ose përdoruesit fundor derisa autoritetet përkatëse në secilin shtet të bien dakord se janë krijuar mënyrat e përshtatshme për të siguruar integritetin e marrëveshjeve me përdoruesin fundor;
- ▶ përfshirjen e masave më kufizuese në marrëveshjet e ardhshme me përdoruesin fundor për të minimizuar rreziqet e rieksporimit ose ritransferimit të paautorizuar në të ardhmen;
- ▶ një vlerësim të përmirësuar të rrezikut përpara licencimit dhe monitorimin e pas eksportit për eksportet në të ardhmen;
- ▶ përfshirjen e një kërkesë për të ndihmuar në kontrollin në terren për marrëveshjet e ardhshme me përdoruesin fundor.

3.1.6.

INFORMACIONET E NDARA ME QEVERITË E TJERA

Shtetet eksportuese mund të ndajnë me shtete të tjera informacione për rezultatin e çdo hetimi të raporteve për rieksporimin ose ritransferimin e paautorizuar të armëve ose municioneve. Informacionet mund të ndahen gjatë takimeve të Procesit për shkëmbimin rajonal të informacionit (RIEP) për eksportin e armëve, nëpërmjet mekanizmave për shkëmbimin e informacionit me COARM dhe nëpërmjet kanaleve të tjera jo zyrtare.

Informacioni i ndarë me qeveritë e tjera mund të përfshijë informacione shtesë që konsiderohen shumë sensitive për t'u përfshirë në deklaratën për shtyp (shih pikën 3.1.2 më sipër).

Informacioni i i ndarë për rastin e përbashkët duhet të përfshijë:

- ▶ hollësitë për eksportin fillestar, duke përfshirë çdo kufizim të vendosur për rieksporimin ose ritransferimin;
- ▶ të dhëna nëse janë shkelur kufizimet për rieksporimin ose ritransferimin dhe për mënyrën e shkeljes së tyre; dhe
- ▶ detaje të hetimit, duke përfshirë hapat e ndërmarrë, masat e përkohshme që janë vendosur dhe konkluzionet për analiza të ardhshme të rrezikut nga të cilat mund të përfitojnë shtetet e tjera.

3.2. HARTIMI I UDHËZIMEVE QË PARASHTROJNË MARRJEN E MASAVE PËR RASTE TË TILLA

Për të udhëzuar marrjen e masave ndaj devijimeve ose mos-përmbushjeve të marrëveshjeve me përdoruesin fundor, shtetet duhet të hartojnë udhëzime kombëtare. Këto udhëzime duhet të kenë si bazë një sërë elementesh kyçe dhe duhet të jenë të aksesueshëm nga të gjithë zyrtarët që janë ngarkuar me monitorimin dhe marrjen e masave ndaj kontrolleve pas eksportit.

3.2.1. ELEMENTET KYÇE

Udhëzimet që parashtrojnë marrjen e masave në nivel kombëtar ndaj rieksperteve ose ritransferimeve të raportuara në shkelje të marrëveshjeve me përdoruesit fundorë duhet të përfshijnë:

- ▶ llojet, format dhe burimet e raporteve dhe prova të mjaftueshme për të nisur një hetim për shkeljen e mundshme të një marrëveshjeje me përdoruesin fundor;
- ▶ masat që lidhen me licencat e lëna pezull dhe ato pjesërisht të përdorura, si bllokimi ose heqja e licencave, që duhet të vendosen gjatë kohës që është duke u kryer hetimi;
- ▶ nëse, kur dhe si duhet të bëhet publik vendimi për të hetuar një riekспорт ose ritransferim të raportuar;
- ▶ cilat informacione që rrjedhin nga hetimet e raporteve për ritransferim të paautorizuar duhet të ndahen me shtete të tjera; dhe
- ▶ procedurat për përfshirjen e gjetjeve të hetimeve në vlerësimet e ardhshme të rrezikut dhe në zhvillimin e vetë udhëzimeve.

3.2.2. DISPONUESHMËRIA E UDHËZIMEVE

Udhëzimet që parashtrojnë marrjen e masave në nivel kombëtar ndaj raporteve për riekспорт ose ritransferim të paautorizuar duhet të vihen në dispozicion të të gjithë zyrtarëve të ngarkuar me monitorimin e përdorimit fundor dhe zbatimin e masave të marra. Megjithëse nuk është e nevojshme që këto udhëzime të vihen në dispozicion të publikut të gjerë, vënia e tyre në dispozicion do të rriste ndërgjegjësimin për përkushtimin për të zbatuar marrëveshjet e përdoruesve fundorë dhe do të rriste transparencën në rast të një incidenti të raportuar.

CIP - Каталогизација у публикацији -
Народна библиотека Србије, Београд

339.564:623.44(4-12)(0.034.2)

BROMLEY, Mark, 1977-

Udhëzim për trajtimin e rieksperteve ose ritransferimeve të paautorizuara të armëve dhe municioneve [Elektronski izvor] / [Mark Bromley i Lawrence Dermody]. - Beograd : SEE-SAC, 2015 (Beograd : DMD). - 1 elektronski optički disk (CD-ROM) ; 30 cm

Prevod dela: Toolkit for Addressing Unauthorized Re-export or Re-transfer of Arms and Ammunition. - Nasl. sa naslovnog ekrana. - Tiraž 50. - Napomene i bibliografske reference uz tekst.

ISBN 978-86-7728-216-5

1. Dermody, Lawrence, 1983- [аутор]

а) Оружје - Извоз - Југоисточна Европа

COBISS.SR-ID 212746508

